



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primar / Doretuar Prilipenat/Prodato Received/Delivered	08-08-2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/HCW	4602/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.671/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani--kryetar, Malsore Bajraktari Gashi dhe Jeton Koca -anëtar, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2365/2021 të datës 01.07.2022 të Gjykatës Themelore të Prishtinës -Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.671/2021 të datës 21.07.2021 të parashtruar nga ankuesit

përfaqëson me adresë dhe të cilët me autorizim i Prishtinë, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 neni 16 paragrafi 3, neni 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.671/2021 e datës 21.07.2021 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesit,

që të gjithë të punësuar në Komunën e Gjilanit, me datë 21.07.2021

përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit _____ në parashtruar ankesë me numër protokoll 3502/2021 të regjistruar me numër A.nr.671/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e shujtave ditore, duke filluar nga data 01.01.2015 e deri me datën 31.12.2018, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.07.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Gjilanit. Komuna e Gjilanit, me datë 10.08.2021 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 02.09.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar , pasi ka pranuar Njoftimin e datës 02.09.2021 me numër protokoll 4477/2021, ka parashtruar kërkesë padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, duke iniciuar konflikt administrativ, e cila me datë 01.07.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër Anr.2265/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesve, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 02.09.2021 për ankesën me numër Anr.671/2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 21.07.2021 me numër protokoll 3502/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.07.2021 me numër protokoll 3502/2021 përmes avokatit _____ të regjistruar me numër A.nr.671/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në kërkesë e datës 21.06.2021; Autorizim i datës 03.06.2021; Autorizim i datës 25.05.2021 nga _____
Autorizimi i datës 25.05.2021 për _____ Autorizimi nga _____
Autorizimi i datës 25.05.2021 nga _____ Autorizimi i datës 25.05.2021 nga _____
Autorizimi i datës 04.06.2021; Autorizimi i datës 03.06.2021; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit dy faqe; Njoftimi i datës 02.09.2021 me numër protokoll 4477/2021 dhe Aktgjykimin A.nr.2365/2021 të datës 01.07.2022 të Gjykatës Themelore të Prishtinës -Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Komunën e Gjilanit dhe gjatë kësaj periudhe fare nuk kanë parashtruar kërkesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjilanit, për kompensimin e shujtës ditore për ditët e pranisë në punë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive duke filluar nga data 01.01.2015 e deri me datën 31.12.2018.

Ankuesit me datën 21.06.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar kërkesë me nr.02-016-65955 në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit me pretendimin ankimor për kompensimin e shujtave për periudhën 01.01.2015 deri më datën 31.12.2018 sipas Kontratës Kolektive. Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit me datë 26.06.2021 i është përgjigjur ankuesve përmes shkresës me numër protokoll 65955/2 me arsyetimin se Komuna e Gjilanit asnjëherë nuk ka bërë asnjë pagesë për shujta për shërbyesit civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar bazën ligjore si dhe pretendimet e ankuesve, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, dhe e njëjta ka qenë e zbatueshme për këtë periudhë kohore pra deri më datë 31.12.2017, mirëpo Kolegji, ka gjetur se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive Kosovës, më datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i saj dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës pas datës 31.12.2017. Bazuar në konstatimin e lartcekur dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa e ankuesve për realizimin e kompensimit të shujtave ditore sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës është parashkruar., kështu që pretendimi i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pabazuar.

Bazuar në shqyrtimin dhe analizimin të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.671/2021, datë 08.08.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Eshref Shabani
Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve Avokatit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-gjyqtari Ramush Bardiqi
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

